

INISIATIVA "PËR QEVERISJEN E HAPUR VENDORE PËRMES INOVACIONIT"

VENDIMARRJE VENDORE E KONSULTUAR E HAPUR TRANSPARENTE



MINI COMPENDIUM
PER KESHILLTARET BASHKIAKE
DHE SHOQERINE CIVIEL

VENDIMARRJA E KESHILLIT BASHKIAK SIPAS KUSHTETUTES DHE LIGJIT

Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtronhet sipas parimit te autonomisë vendore (*Neni 13 i Kushtetutës*).

Organet e qeverisjes vendore kanë të drejtë të nxjerrin nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra (neni 113/2 i Kushtetutes) të cilat kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial të këtyre organeve (*neni 116 i Kushtetutës*). Parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj (*Neni 120 i Kushtetutës*).

Ligi 8652, datë 31.7.2000 “**Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore**”, i ndryshuar, transpozon me besnikëri në dispozitat e tij këto parime kushtetuese.

Funksioni kryesor vendimarrës në nivel vendor realizohet nga këshillat bashkiakë/komunale. Këta të fundit konsiderohen si parlamentet e qyteteve dhe ligji iu ngarkon kompetenca shumë të rëndësishme vendimarrëse, të tilla si caktimi i taksave dhe tarifave vendore, miratimin e buxhetit vjetor, kredi-marrje dhe

grant-marrje në vlera të konsiderueshme, apo edhe vendimarje mjafët kritike mbi territorin dhe pronat që i kanë kaluar tashmë në administrim pushtetit vendor.

Në ushtrim të kompetencave të tyre, këshillat bashkiakë/komunalë nxjerrin vendime me karakter normativ dhe individual, të detyrueshme për t'u zbatuar nga subjektet nën juridiksionin e tyre. Ligji 8652, datë 31.7.2000 “**Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore**”, i ndryshuar, normon me hollësi procesin e shqyrimit, votimit dhe shpaljes së vendimeve të këshillave bashkiakë/ komunalë (*neni 33 i ligjit 8652*).

Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vendos përrastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë.

Pas ndryshimeve që pësoi **ligji 8652** në vitin 2004, parashikohet vetëm një rast kur vendimet duhet të merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, dhe kjo është konkretist në rastin kur Këshilli “**miraton tjetësimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve**”.

NENI 32

KOMPETENCAT E KËSHILLIT

- a) Miraton statutin e komunës ose të bashkisë, si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të vet.
- b) Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e këshillit.
- c) Emrón dhe shkarkon sekretarin e këshillit komunal ose bashkiak.
- c) Miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së komunës ose të bashkisë, të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të komunës ose të bashkisë, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikimin, pagat dhe mënyrat e shpërbërimit të punorëve të tjerë personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përpunje me legjislacionin në fuqi.
- d) Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërisë tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojn vetë ose është bashkëthemelues.
- dh) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
- e) Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.
- ë) Organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të komunës ose bashkisë.
- f) Vendas përsaktat tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.
- g) Vendos përmarrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.
- gj) Vendos përkrijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes vendore, përfshи subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë.
- h) Vendos përfillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet.
- i) Zgjedh përfaqësuesit e këshillit komunal ose bashkiak në këshillin e qarkut.
- j) Vendos përdhënien ose heqjen e mandatit të këshillitarit.
- k) Miraton norma, standarde e kritere përrregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe përmbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.
- l) Vendos përsimbollet e komunës ose të bashkisë.
- ll) Vendos përemërtimin e rrugëve, të shesheve, të territoreve, të institucioneve dhe të objekteve në juridikacionin e komunës ose të bashkisë.
- m) Jep tituj nderi dhe stimul.
- n) Vendos përrregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe përzbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim te komuna ose bashkia.

NENI 33

VOTIMI

- 1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vendos përrastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kur doherë me votim të fshehtë.
- 2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
- 3. Vendimet, përrastet e parashikuara në shkronjat "b", "c", "d", "dh", "f", "g", "gi", "i" dhe "s" te nenit 32 te këtij ligji, merren me shumicën e votave te numrit te përgjithshëm te anëtarëve te këshillit.
- 4. Vendimet merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit përrastet e parashikuara në nenin 32 shkronja "e" e këtij ligji.
- 5. Në rastet e votimit përrastet kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave.
- 6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njofimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

PJESEMARRJA E QYTETARËVE NË VENDIMARJE, NJE GARANCI KUSHTETUESE DHE LIGJORE

Pushteti vendor në Republikën e Shqipërisë ka përmision kryesor sigurimin e qeverisjes në nivel sa më afër shtetasve përmes “respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sankcionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera” (*Neni 3, ligji 8652*).

E drejta e pjesëmarrjes në vendimarrje garantohen në **Kushtetutë**. Në kreun “**Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut**”, neni 23/3 përcakton shprehimi si se “Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive”.

Këto garanci kushtetuese janë transpozuar me besnikëri në dispozitat e **ligjit 8652**, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

Neni 34, pika 1 e këtij ligji përcakton shprehimi si: “Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit”.

Këshilli komunal ose bashkiak, përpëra shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me

bashkësinë (*Neni 35/1*). Seancat e këshillimit me bashkësinë janë të detyrueshme kur Këshilli:

- dh) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.*
- e) Miraton tjetësimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.*

- f) Vendos për taksat e tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.*
- k) Miraton norma, standarde e kriterie për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.*

Këshillimi me bashkësinë bëhet duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore (*neni 35/2*).

Pra, pjesëmarrja e publikut ne vendimarrje ndodh përpara dhe gjatë votimit të akteve nga Këshilli. Konsuktimi paraprak i projekt-vendimeve është një detyrim ekskluziv i Këshillit dhe jo i kryetarit të Bashkisë.

NENI 23 I KUSHTETUTES

- 1) E drejta e informimit është e garantuar.
- 2) Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
- 3) Kujdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

NENI 34, "MBLEDHJET E HAPURA"

1. Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e myllur.

Konsultimet, sidomos ato për buxhetin që ndërmerren rëndom nga kryetarët e bashkive, mbeten të konsiderohen si një proces ekstra-ligjor. Sipas nenit 36, gjermana "a", "Kryetari i bashkisë ushton të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të komunës ose bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës". Konsultimet publike për buxhetin dhe paketën fiskale por edhe ato për tjetërsim pronë, apo për miratim normash dhe standartesh, janë kompetencë dhe detyrim ligor ekskluziv i Këshillit.

Nismat e ndërmarra nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile të cilat venë në qendër të proceseve të konsultimit me bashkësinë kërët e bashkive dhe jo Këshillin Bashkiak, janë me legjitimitet të diskutueshëm dhe nuk i shërbejnë promovimit të kulturës së respektit ndaj të ligjit nga organet e qeverisjes vendore.

HYRJA NE FUQI E VENDIMEVE TE KESHILLIT DHE AKSESI NE LEGJISLACIONIN VENDOR

Lidhur me shpalljen dhe hyrjen në fuqi të vendimeve të këshillave bashkiakë / komunalë, neni 33/6 përcakton se “*Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të këtyre subjekteve që përfshihen në to.*”

“*Aktet e Këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga ky i fundit, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre...*” (Neni 35, pika 3, fjalia e parë). Këto forma të tjera mund të janë një perodik apo Fletore Zyrtare Lokale, ose përmes publikimit elektronik (në intenet).

Në këtë pikë, modalitetet juridike të vendimarrjes dhe ato të transparencës me publikun janë praktikisht të shkrira organikisht tek njëra tjetra (ose zgjatime të njëra tjetër). Zbatimi i këtyre dispozitave është kusht **juridik** dhe **faktik** për të garantuar aksesin e publikut në legjislacionin lokal, në kuptimin e njohjes efektive të tij me aktet që miraton Këshilli

Bashkiak. Konkretizimi i vendimeve në letër nga ana e ketij të fundit si dhe shpallja dhe njoftimi i tyre përfaqësojnë materializimin e të gjithë procesit vendimarrës. Ato janë sinteza apo produkti final i gjithë procesit vendimarrës. Edhe pse publikut mund t'i jetë garantuar pjesëmarrja (fizike) në procesin vendimarrës, në rastin kur atij nuk i garantohen mundësi efektive të njohjes me vendimet ku materializohet ky proces, vetë pjesëmarrja e humbet qëllimin.

Publikimi i vendimeve (akteve) përbën një nga parimet themelore të qeverisjes, qoftë në nivel në nivel qendror ashtu edhe vendor. Ky parim afirmon kushtin që subjektet fizike dhe juridike të mund të njohin normat ligjore që nxjerrin organet qeverisëse në mënyrë që të kenë mundësi më pas t'i zbatojne ato. Për këtë arsy, publikimi i tyre është një detyrim kushtetues dhe ligjor për organet qeverisëse dhe në shumicën e rasteve, kusht për hyrjen e tyre në fuqi.

Aktualisht, Këshilli Bashkiak, Durrës publikon vendimet e veta në portalin WWW.VENDIME.AL i cili është i linkuar në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.

NENI 33**VOTIMI**

6. Aktet e këshillit shpalllen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njofitimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

NENI 35,**SEANCAT E KËSHILLIMEVE ME BASHKËSINË
DHE E DREJTA E PUBLIKUT PËR T'U INFORMUAR**

3. Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim

www.vendime.al është krijuar dhe mirëmbahet nga INFOÇIP. Ai është një databazë e fuqishme online ku publikohen vetëm vendimet e Këshillave Bashkiakë të 8 bashkive krysore te vendit, dhe është në zgjerim të vazhdueshëm. VENDIME.AL është emërtimi i shkurtuar në rrjet për: Arkiva Kombëtare e Vendimeve të Këshillave Bashkiakë në Republikën e Shqipërisë.



SI TE VLERESOJME NESE VENDIMARRJA E KËSHILLIT ËSHTË E BAZUAR NË LIGJ, TRANSPARENTE DHE E KONSULTUAR ME PUBLIKUN

Ligjvënësi ka lidhur organikisht në dispozitat e ligjit 8652 rregullat dhe procedurën për vendimarrjen e të zgjedhurve vendorë me të drejtën e publikut për të qenë i përfshirë në këtë vendimarrje. Kjo përfshirje e publikut aktivizohet **në fillim, gjatë** dhe **në fund** të procesit vendimarrës. Konkretilisht kjo nënkupton shqyrtimin paraprak të një kategorie aktesh me publikun e interesuar, ndjekjen e mbledhjeve në sallë teksa ato zhvillohen si dhe aksesin në vendimet e materializuara të Këshillit. Nenet 34 dhe 35 të ligjit 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, janë mishërimi praktik i kësaj lidhjeje organike që synon garantimin e një procesi vendimarës transparent dhe të hapur ndaj publikut. Kurse nenit 33 normon në tërësi procedurën e votimit dhe mënyrën e hyrjes në fuqi të vendimeve të Këshillit. Zbatimi rigoroz i këtyre tre neneve është kusht juridik për të patur një vendimarrje të bazuar në ligj, transparente dhe të konsultuar me publikut.

Matja e nivelit të implementimit të neneve 34 dhe 35 prodhon indikatorët për vlerësimin objektiv të nivelit të

përfshirjes së publikut në vendimarrjen lokale dhe transparencës së kësaj të fundit. Kurse matja e nivelit të implementimit të nenit 33, indikon legjitimitetin e akteve dhe fuqinë e tyre juridike.

Zhvillimi i një metode për matjen e nivelit të zbatimit të këtyre tre neneve dhe implementimi në praktikë i saj ka qenë një ndër objektivat kryesorë të Qendrës për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP që prej 2010-ës.

Mjeti kryesor metodologjik që u zhvillua nga INFOÇIP u emërtua **PROAKTIV** (akronim i modifikuar për: **Protokoll i Vlerësimit te Transparencës Vendimarrëse në Këshillin Bashkiak përmes Pjesëmarrjes Aktive**). Ky protokoll është *sui-generis*, që do të thotë se është “*qepur pas trupit*” të legjislacionit përkates në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në rastin konkret ligji 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar. Në vija të përgjithshme, qasja **PROAKTIV** ndërthur në një bllok të vetëm **monitorimin e ligjshmërisë së procesit vendimarrës të Këshillit Bashkiak përmes pjesëmarrjes dhe raportimit aktiv qytetar**.

TRANSPARENCE DHE PJESEMARRJA E NË VENDIMARRJE KËSHILLIT BASHKIAK



Shih online mbledhjet
e Keshillit Bashkiak



National Endowment
for Democracy
Supporting freedom around the world

VENDIMARRJA NË KËSHILLIN BASHKIAK DURRËS DHE PJESEMARRJA QYTETARE
**NJË MODEL TRANSPARENCE
DHE LIGJSHMËRIE**



INISIATIVA "PËR OVERTISJEN E HAPUR, VENDORE PËRMES INOVACIONIT"
VENDIMARRJE VENDORE
E KONSULTUAR
E HAPUR
TRANSPARENTE

INISIATIVA "PËR OVERTISJEN E HAPUR,
VENDORE PËRMES INOVACIONIT"



**VENDIMET
E KËSHILLIT BASHKIAK
DURRES
ONLINE**



Realizuar nga:
INFOCIP
INFOCOMPUTER & CONSULTING

Albësuar nga:
NED National Endowment
for Democracy

AKTORË NDËRKOMBËTARË QË ADRESOJNË PJESEMARRJEN DHE INOVACIONIN NË QEVERISJEN LOKALE

PER
KESHILLAT
BASHKIAKE
DHE
SHOQERINE
CIVILE



KËSHILLI I EUROPËS

Shqipëria është shtet anëtar i Këshillit të Europës që 13 korrik të vitit 1995. Në 4 prill, 2000, Kuvendi i Shqipërisë ratifikoi Kartën Europiane të Veto-Qeverisjes Vendore.

Në 16 Korrik, 2010, Qeveria shqiptare, miratoi edhe Protokollin shtesë të Këshillit të Europës për Kartën e Qeverisjes Lokale, me titull "Per implementimin e masave për garantimin e së drejtës për pjesëmarrje" (Utrecht, 16.XI.2009). Sipas nenit 2 të këtij Protokolli:

- 1 Palët marrin të gjitha masat e nevojshme për të vënë në jetë të drejtën e pjesëmarrjes në punët e organit vendor.
- 2 Këto masa për ushtrimin e së drejtës për pjesëmarrje përfshijnë:
- i) fuqizimin e organeve vendore për të bërë të mundur, nxitur dhe lehtesuar ushtrimin e së drejtës për pjesëmarrje, siç parashikohet në këtë Protokoll;
 - ii) sigurimin e përcaktimit të:

- a) procedurave për përfshirjen e njerëzve, të cilat mund të përfshijnë proceset konsultative, referendumet dhe petitionet vendore dhe masa për përfshirjen e njerëzve në një nivel që është më pranë tyre në rast se organi lokal ka shumë banorë dhe/ ose mbulon një zonë të madhe gjeografike;
- b) procedurave për akses në dokumentet zyrtare të mbajitura nga organet lokale, në përputhje me rendin kushtetues të palës dhe me detyrimet ligjore ndërkombëtare të saj;
- c) masave për plotësimin e nevojave të kategorive të personave të cilët hasen me vështirësi specifike lidhur me pjesëmarrjen; dhe
- d) mekanizmave dhe procedurave për të trajtuar dhe për t'ju përgjigjur ankesave dhe sugjerimeve lidhur me funksionimin e organeve vendore dhe shërbimet publike vendore;

iii) inkurajimin e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit për nxijen dhe ushtrimin e të drejtës për pjesëmarrje, të parashikuar në këtë Protokoll.

- 3) Procedurat, masat dhe mekanizmat mund të janë të ndryshme për kategori të ndryshme të organeve vendore, duke pasur parasysh madhësinë dhe kompetencat e tyre.
- 4) Gjatë proceseve të planifikimit dhe të vendimmarjës lidhur me masat që duhet ndërmarrë për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës për pjesëmarrje në punët e një organi vendor, organet vendore konsultohen sa më shumë të jetë e mundur në kohën e duhur dhe në mënyrën e përshtatshme.

AKTORË TË TJERË QË ADRESOJNË PJESEMARRJEN DHE INOVACIONIN NË QEVERISJEN LOKALE

QEVERIA SHQIPTARE ka njojur zyrtarisht problematikën që ka të bëjë me publikimin e akteve që nxjerr Pushteti Vendor dhe e ka adresuar për zgjidhje në kuadër të Strategjisë së Reformës Ndër-Sektoriale në Administratën Publike 2009-2013, miratuar me VKM nr. 1017, dt 18.9.2009.

Sipas këtij dokumenti zyrtar shumë të rëndësishëm “Vendimet normative të bashkive ...janë shumë të vështira për t'u gjendur”. (*KAPITULLI I – Vështrim i përgjithshëm mbi situatën, 1.4.1: Procesi Administrativ*)

Strategjia vendos objektiva konkretë për të përmirësuar situatën e konstatuar brenda vitit 2013. Konkrektisht, në *KAPITULLIN II “Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike”*, në pikën 2.4 , kërkohet shprehimi që të nxitet:

- transparenca në vendimarrjen normative dhe administrative,
- zgjerimi i konsultimit publik dhe i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen për politikat,
- akses më të mirë në informacionin publik dhe në aktet administrative,
- Përdorimi masiv i teknologjisë moderne të informacionit dhe publikimi elektronik zyrtar i vendimeve administrative.

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E
ORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE (SNRAP) NË
DËR TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIM
DHE INTEGRIM**

2009 - 2013



I.4.1 Proceset administrative

Në sistemin e rishikimit administrativ konstatohet deficencë lidhur me procesin e ankimit pasi pothuajse të gjitha aktet nxirren nga titullari. Një tjetër problem ka të bëjë me faktin se vendimet normative të bashkive, degëve të ministritë etj. janë mjaft të vështira për t'u gjendur. Për më tepër, praktika tragon se haset në rezistence kur tentohet të realizohet forma elektronike e komunikimit ndërmjet institucioneve.

KAPITULLI II

2. Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike

- Një administratë që bazohet në procese vendimarrëse, transparente, përfshirëse dhe e përgjegjshme ndaj publikut.

3.2 Në nivel rajonal/vendor

Paralelisht me decentralizimin e funksioneve, të kombinuar me delegimin e vendim-marrjes dhe përdorimin e teknologjive të reja, synohet një tkurreje graduale e degëve në territor. Shumë nga njësitë territoriale do të riorganizohen, përfshirë funksione të përbashkëta, duke racionalizuar edhe realizimin e shërbimeve të veta mbështetëse.

Në procesin e riorganizimit duhet të mbahen parasysh papajtueshmëritë e mundshme ndërmjet funksioneve të ndryshme.

2.4 Përmirësimi i procedurave dhe mjeteve të vendim-marrjes dhe kryerjes së shërbimeve në administratën publike

- Në këtë drejtim ka nevojë të nxitet më tej:
- transparencia në vendimarrjen normative dhe administrative,
- zgjerimi i konsultimit publik dhe i pjesëmarrjes së publikut në vendimarrjen për politikat,
- lehtësimi i përbushjes së detyrimeve administrative nga qytetarët (one-stop shop, miratimi ne heshtje),
- akses më të mirë në informacionin publik dhe në aktet administrative, përmirësimi i procedurave të ankimit administrativ brenda administratës dhe më tej në gjykatat administrative,
- përdorimi masiv i teknologjisë moderne të informacionit dhe publikimi elektronik zyrtar i vendimeve administrative.

ÇFARE KA BERE INFOÇIP NË DURRËS PËR TË PROMOVUAR PJESËMARRJEN NË VENDIMARRJE & RRITJEN E TRANSPARENCËS PERMES INOVACIONIT

Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOÇIP dhe struktura e saj në Durrës në Durrës, Rrjeti për Transparencë Qytetare, që prej Majit 2011 janë duke punuar me përkushtim për të promovuar rritjen e cilësisë së vendimarrjes në Këshillin Bashkiak Durrës përmes Monitorimit dhe Inovacionit si dhe për të krijuar dhe konsoliduar një standart krejt të ri të pjesëmarrjes së pubikut në vendimarrjen e qytetit. Ky program ambicioz, i cili ka arritur standarde të panjohura më parë, po mbështetet për të dytin vitin rradhazi nga National Endowment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C.

PROGRAMI I DIXHITALIZIMIT

Ne dixhitalizuam vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës që nga viti 2007 e deri sot, duke i bërë ato të aksesueshme on-line. Kjo databazë u host-ua fillimi ishtë faqen zyrtare të Qendrës për Çështje të Informimit Publik, www.infocip.org dhe u link-u edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.

Motoja e punës sonë është: "*Qytetarët durrsakë duhet të dijnë se cfarë vendimesh merren në emër të tyre*". Një qytetar i informuar mbi normat që qeverisini qytetin e tij, është padyshim një qytetar më i mirë.

Qe prej fillimit të vitit 2013, databaza dixhitale e vendimeve të Këshillit Bashkiak u rihodh nga e para në një portal të ri online, www.vendime.al, që ofron avantazhe maft të rëndësishme kahasuar me sistemin e vjetër të arkivimit, sidomos përsa i takon gjetjes së vendimeve online me fjalë kyçë nga cilid interesuar

VENDIME.AL është emërtimi i shkurtuar në rrjet për: **Arkiva Kombëtare e Vendimeve të Këshillave Bashkiakë në Republikën e Shqipërisë**. Aktualisht, VENDIME.AL përmban vendimet e këshillave bashkiakë (VKB) të 8 prej bashkive kryesore të Shqipërisë, që nga viti 2007 e deri më sot, mes të cilave edhe ato të Durrësit, Ajo është në përditësim dhe në zgjerim të vazhdueshëm, tashmë edhe me kontributin direkt të bashkive përfteuse, të cilat kanë akses të individualizuar në hedhen e të dhënave. Faqja e individualizuar për Durrësin në www.vendime.al është direkt e linkuar në faqen zyrtare të bashkisë Durrës.

PROGRAMI I PJESEMARRJES QYTETARE

Ne punuan për të sjellë më shumë qytetarë në sallën e Këshillit e Bashkiak. Në vitin tonë të parë të punës në Durrës, ne arritëm që, falë bashkëpunimit me kryetarin e Këshillit Bashkiak, z. Indrit Hamiti, të implementojmë praktikisht funksionet ligjore të Këshillit për ndërmarrjen e konsultimeve publike përvendimarijet më të rëndësishme, siç janë ato për Paketën Fiskale, Buxhetin e Bashkisë, etj.

Po ashtu, për herë të parë u realizua edhe diskutimi i buxhetit përvendimari 2012, me pjesëmarrjen direkte jo vetëm të mësuesve por edhe nxënësve durrsakë, një risi absolute që realizohet për here të parë jo vetëm në Durrës, por në të gjithë Shqipërinë. Konsultime të tjera në kuadër të partneritetit Këshill Bashkiak-INFOÇP u zhvilluan edhe për cështje të tjera, sikurse ishin edhe takimet me grupet gjinore, përnjë përfshirje sa më të plotë të tyre në vendimarrje.

Në vitin e dytë të punës në Durrës, INFOÇP realizoi në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Bashkiak, diskutimin e Planit të Përgjithshëm Vendor me grupet e interesit. Ky takim shumë i rëndësishëm është i vërtmi konsultim në të gjithë Shqipërinë i cili u thirr direkt nga Këshilli Bashkiak (në të gjitha rastet e tjera, PPV i janë nënshtuar konsultimeve nëpër takime të thirrura nga administrata bashkiake).

VIDEO-ARKIVA E KËSHILLIT BASHKIAK

Falë ÇIP, të gjithë qytetarët e Durrësit kanë tashmë mundësi që të ndjekin edhe online, në një video-arkiv moderne të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak në audio-video. Kjo qasje krejt unike, prezantuar dhe realizuar nga Qendra ÇIP, i shërben më së miri të gjithë qytetarëve durrsakë, brenda apo jashtë vendit, për të të qenë në dijeni të vazhdueshme të proceseve vendimarrëse në qytetin e tyre. Ajo i jep një dimension të ri transparencë veprimtarisë së Këshillit Bashkiak, Durrës, duke e bërë atë kështu të vëtmin në RSH, që disponon një video-arkiv të aktivitetit të vet vendimarrës (bashkë me Korçën), por edhe një lider në rajon sa i takon promovimit të transparencës në vendimarrje përmes teknologjive të reja të informacionit.

Kjo videoarkivë është prodhuar dhe administrohet nga INFOÇP dhe është e linkuar edhe në faqen zyrtare të bashkisë Durrës. Po ashtu, video-arkiva mund të hapet dhe të shikohet edhe përmes portalit: www.vendime.al, nëse hyni më parë në faqen ku hapen vendimet e këshillit bashkiak Durrës.

Krahas kësaj video-arkive, INFOÇP ka dokumentuar në audio-video dhe ka hedhur online të gjithë programin e konsultimeve me publikun të ndërmarrë në dy vjet prej saj, në bashkëpunim me këshillin Bashkiak, Durrës. Ju mund të vizitonit këtë program duke klikuar tek: http://www.infocip.org/al/?page_id=9971

Kjo risi absolute është unike dhe asnjë nga bashkitë e Shqipërisë nuk e disponon përvce Durrësit. Ajo është një provë e padiskutueshmë e suksesit të arritur nga INFOÇP në ndërthurjen e programit të vet të pjesëmarrjes së publikut me teknologjitet e reja të informacionit, duke i dhënë një dimension të ri punës së ndërmarrë në këtë drejtim nga organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri.

“QEVERISJE VENDORE E HAPUR PËRMES INOVACIONIT”

është nismë e Qendrës për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP. Llogaridhënia, Transparency, Ligjshmëria dhe Inovacioni në Pushtetin Vendor janë katër shtyllat bazë mbi të cilat mbështetet kjo Inisiativë. Ajo fryshtohet nga “12 Parimet e qeverisjës së mirë dhe demokratike në nivel vendor” të Këshillit të Eropës, dhe Inisiativa për Qeverisjen e Hapur e Presidentit të SHBA, Barack Obama.

“Qeverisje Vendore e Hapur përmes Inovacionit” ka në fokus të saj proceset vendimarrëse në bashkitë e Shqipërisë. Motoja e këtij programi kombëtar është: “Qytetarët duhet ta dijnë se çfarë vendimesh merren në emër të tyre”.

Inisiativa synon që, përmes teknologjive të reja të informacionit të adresojë njëherë e mirë për zgjidhje problemet serioze të trashëguara në Shqipëri në drejtim të aksesit në legjislacionin vendor. INFOÇIP, ka nisur tashmë dixhitalizimin e vendimeve të këshillave bashkiakë në të gjitha bashkitë kryesore të Shqipërisë, për t'i bërë ato të gjetshme dhe të shfletueshme në internet nga të gjithë të interesuarit, në çdo kohë dhe pa pagesë.

Platforma onlinë www.vendime.al që ka realizuar INFOCIP është një kontribut ekskluziv i shoqërisë civile dhe është unike në llojin e saj, jo vetëm në rajon por edhe më gjerë. Ajo i jep një dimension të ri transparencës në vendimarrjen e pushtetit lokal në Republikën e Shqipërisë.